



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	10.04.2018	Dep. DPK	Nr. Prot. 03-03/1126/18
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1071/18	Nr. 1 faq. 03	Data 10.04.2018
PËR/ZA/TO:	z. Fitim MUSTAFA Menaxher i zyrës së Prokurimit në Ministria e Integrimit Evropian		
CC:	z. Demush Shasha Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Integrimit Evropian		
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: "Shërbime të hostimit të platformës për ndihma nga jashtë" me nr. të prokurimit 218/18/1821/221, nr. të brendshëm MIE/218/18/008/221.		

I nderuari z. Mustafa,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: "Shërbime të hostimit të platformës për ndihma nga jashtë" me nr. të prokurimit 218/18/1821/221, nr. të brendshëm MIE/218/18/008/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: "Shërbime të hostimit të platformës për ndihma nga jashtë" me nr. të prokurimit 218/18/1821/221, nr. të brendshëm MIE/218/18/008/221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për

Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetime

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 05 prill 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1071/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Shërbime te hostimit te platformës për ndihma nga jashtë”** me nr. të prokurimit 218/18/1821/221, nr. të brendshëm MIE/218/18/008/221, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Integrimit Evropian.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike kornizë 36 muaj, llojit shërbime, me vlerë të mesme te parashikuar prej 43,000.00. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: *“Operatori ekonomik duhet të ketë përfunduar me sukses së paku 2 (dy) kontrata të natyrës së njëjtë qoftë me institucione qeveritare apo edhe ato të fushës bankare”*, ndërsa tek dëshmia e kërkuara dokumentare është kërkuar: *“Një listë të shërbimeve (kontratave) të realizuara lidhur me kërkesën ne piken 1. Duke saktësuar: llojin e shërbimeve të përfshira, përafërsisht shumën e kontratës, periudhën e realizimit, Autoritetin kontraktues etj, (Lista të jetë origjinale nga OE), se dhe minimum 2 (dy) referenca të lëshuara për kontrata që i keni ne listë (referencat-kopje)”*, kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Bazuar në legjislacioni në fuqi konkretisht nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenin 26.8 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se një autoritet kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkoj si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, duhet të ceket *referenca apo certifikata të autoriteteve publike dhe personave privat*, e jo siç ka vepruar në rastin konkret autoriteti kontraktues duke cekur kontrata të natyrës së njëjtë qoftë me institucione qeveritare apo edhe ato të fushës bankare.

Andaj, Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se kërkesa e specifikuar ne nenin III.2.4. në njoftimin për kontratë, është në kundërshtim me nenin 69 paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, ku thuhet: Listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke

saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënenshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Agjencia pas trajtimit të dokumentacionit për tenderin me titull: **“Shërbime te hostimit te platformës për ndihma nga jashtë”** me nr. të prokurimit 218/18/1821/221, nr. të brendshëm MIE/218/18/008/221, ju njofton me të gjeturat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

